



Pranuar / Dorezuar Pritjen/Prodato Received/Delivered	08-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ./Jedinstva Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMESHUK	4427/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.545/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.454/2023 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga „ / kundër organit të punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike “kërkese nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.05.2023, mori këtë;

V E N D I M

HEDHET poshtë, si e palejuar ankesa me numër A.nr.454/2023 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, më datë 22.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2879/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 02.03.2023, të Menaxheres së Personelit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 31.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ndërsa me datë 20.04.2023 Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka dërguar përgjigjen në ankesën tek Këshilli.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 545/2023 me numër të protokollit 2879/2023 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë e datës 02.03.2023; Vendimi i datës 23.09.2016; Vendimi i datës 21.12.2015; Vendim i datës 21.06.2018, për ndryshimin e Rregullores së Brendshëm; Vendimi i datës 23.05.2017; e-maili i datës 14.06.2018; kërkesë e datës 10.01.2017; Raporti i datës 15.02.2017; e-maili i datës 30.09.2015; Akt Emërimi i datës 11.01.2012; Vendimi i datës 27.02.2015; Vendimi i datës 29.03.2016; Vendimi i datës 23.10.2017; Kërkesë e datës 10.01.2017; Përgjigje në ankesë e datës 20.04.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e pa lejuar, sepse,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës, me rastin e vendimit me numër protokollit 14/15, të datës 21.12.2015, me të cilin vendim është caktuar ushtrues i detyrës së Drejtoratit të Gjeoinformacionit, nëpunësin civil \_\_\_\_\_ dhe se vazhdon të jete ende aktive, ndërsa ankuesi \_\_\_\_\_ ka takuar me ankesë një vendim të datës 21.12.2015, prandaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi ankesën e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 130 paragrafi 130.1 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili përcakton se: "130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftimin për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin", si dhe jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës".

Ndërlidhur me ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshilli, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ ka qenë i obliguar që ankesën ta parashtrojë në pajtim 1 me Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, në afatin prej (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", prandaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore tjera të ankuesit, sepse ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesës, deri në parashtrimin e ankesës me datë 22.03.2023, në Këshilli.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda A.nr.545/2023

Rushit KAJTAZI

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kadastrale të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

